



FUNCTIONAL UNIT	29	Pr. Post. No.	3087
SECTOR	02	Date	25.11.21

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore -
Ministry of Foreign Affairs and the Diaspora

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	457/2021				
PËR/ZA/TO:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme – Zyra Kombëtare e Auditimit				
CC:	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – MPJD				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Donika Gërvalla-Schwarz, Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të performancës				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	401	Lokacioni: Kuceni: Extension:	Rr. "Luan Haradinaj", 10000, Prishtinë	Data: Datum: Date:	24.11.2021
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE:					X

E nderuara znj. Spanca,

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka pranuar raportin përfundimtar të auditimit të performancës "Kontratat e centralizuara - Shërbimet e transportit ajror", nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, kemi përgatitur dhe po ju dërgojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport, për të gjeturat dhe rekomandimet që përfshijnë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Jam plotësisht e vendosur për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm dhe e përkushtuar për vendosjen e rregullit dhe të disiplinës financiare, si dhe për ngritjen e përgjegjësisë së kontrollit të brendshëm në kuadër të MPJD-së gjatë shpenzimit të parashë publike.

Me respekt!

Nr.	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra apo të planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Të përdorin klasën ekonomike për t'i shmangur shpenzimet e larta të transportit ajror, me përjashtim të rasteve kur UA i rishikuar do të lejonte shfrytëzimin e klasave tjera;	Përmes rritjes së nivelit të mbikqyrjes sigurohet që gjatë rezervimeve të biletave të përdoren vetëm kategoritë/klasat e lejuara me rregullat e përcaktuara për udhëtime zyrtare. Nga menaxheri i kontratës është kërkuar në formë strikte që të mos bëjë asnjë rezervim të biletave jashtë klasës së lejuar pa një shqyrtim dhe miratim paraprak nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së. Drejtorët e departamenteve përkatëse janë udhëzuar që miratimin e udhëtimeve të vartësve të tyre ta bëjnë vetëm në rastet, kur një udhëtim i tillë është i pashmangshëm. Miratimi përfundimtar bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm.	ZKA, Menaxheri i kontratës.	TM4_2021
2	Të planifikojnë udhëtimet më mirë në mënyrë që të shmangin nevojën për anulime dhe shtyrje të udhëtimeve.	Do të rritet niveli i kontrollit në këtë sistem, duke kërkuar nga zyrtarët që, në rastet e udhëtimit/pjesëmarrjes në takime/aktivitete, të bëhet një planifikim më i mirë i agjendës, në mënyrë që të mos bëhet anulimi i biletave të rezervuara dhe të mos krijohen shpenzime të paarsyetuara.	ZKA, Menaxheri i kontratës.	TM4_2021